



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të mërkurën, më 26 prill 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelet e 20 personave për të marrë pjesë në proces gjyqësor si viktimat, të cilët kishin apeluar vendimin e Trupit Gjyqësor ku refuzohej kërkesa e tyre për pjesëmarrje në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*. Paneli, sidoqoftë, vendosi se personat mund të dorëzojnë sërish kërkesë, në qoftë se i paraqesin informacione të reja Trupit Gjyqësor. Apelet u dorëzuan nga dy mbrojtës që përfaqësojnë 20 personat të cilëve iu refuzuan kërkesat.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 28 prill, Trupi Gjyqësor II rrëzoi kërkesën e ZPS-së për miratimin e një procedure për rastet kur mund të dalë aspekti/ i vetinkriminimit nga dëshmitari, në bazë të rregullës 151. Trupi Gjyqësor është i mendimit se rregullat 43 dhe 151, të marra së bashku me paragrafin 97(v) të Urdhrit për Zhvillimin e Gjykimit, e rregullojnë siç duhet aspektin e vetinkriminimit (të mundshëm) nga dëshmitarët, në këtë fazë të procesit gjyqësor.

Në bazë të rregullës 151, një dëshmitar mund të kundërshtojë të japë dëshmi që mund ta inkriminojë. Megjithatë, Trupi Gjyqësor mund të detyrojë një dëshmitar të dëshmojë, për shembull, nëse dëshmitari do të japë dëshmi unike për çështjen gjyqësore. Në një rast të tillë, Trupi Gjyqësor duhet t'i japë garanci dëshmitarit se Gjykata nuk do të veprojë lidhur me vetinkriminimin para dhënies së dëshmisë.

Më 1 maj 2023, dhe në vijim të vendimit nga Trupi Gjyqësor, Administratorja përfundoi emërimin e z. Jang si mbrojtës të z. Selimi dhe caktoi z. Roberts si mbrojtës zëvendësues.

Më 25 prill 2023, Zyra Administrative mori një letër nga z. Selimi ku kërkonte tërheqjen e z. Dejvid Jang si mbrojtës të tij dhe Xhefri Roberts, bashkëmbrojtës në ekipin e tij të mbrojtjes, të caktohej si mbrojtës zëvendësues. Z. Selimi jepte një përshkrim të shkurtër të arsyeve për kërkesën e tij. Po në të njëjtën ditë, z. Jang i

1





dorëzoi Administratores kërkesë për t'u tërhequr si mbrojtësi i z. Selimi, ku jepte të njëjtat arsye. Bazuar në parashtrimin e Administratores se mund të ndër marrin hapa të menjëhershëm për të caktuar z. Roberts si mbrojtës, për të garantuar përfaqësimin ligjor të z. Selimi në çdo kohë dhe meqenëse z. Selimi ka të drejtë të zgjedhë mbrojtjen e tij, Trupi Gjykses e miratoi këtë kërkesë.

Seancat në këtë çështje gjyqësore do të rifillojnë javën e ardhshme, duke nisur nga e mërkura, 10 maj, në orën 9:00 të paradites.

Në gjykimin e Pjetër Shalës, dëshmitari i pestë dhe i gjashtë të thirrur nga Prokuroria, përfunduan dhënien e dëshmimeve të tyre. Të dy dëshmitarët dhanë dëshmi nën masa mbrojtëse, përmes videolidhjes.

Në çështjen gjyqësore *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, pas kërkesave të z. Gucati dhe z. Haradinaj më 2 dhe 3 maj në lidhje me mbrojtjen e ligjshmërisë, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova caktoi sot Panelin e Gjykatës Supreme që përbëhet prej saj, gjykatëses Kristinë van den Vijngart dhe gjykatësit Daniel Fransen.

Në bazë të Ligjit, z. Gucati dhe z. Haradinaj mund të dorëzonin kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh nga dalja e aktgjykimit të formës së prerë.

Përgjithësisht, Paneli I Gjykatës Supreme caktohet në qoftë se:

- një nga palët ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë,
- Paneli i Gjykatës së Apelit ka prapësuar pafajësinë dhe ka shpallur verdikt fajësie, ose
- kur Trupi Gjykses ose Paneli i Gjykatës së Apelit ka shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm.

Ndër lajme të tjera: DHSK-ja këtë javë organizoi një seminar për gazetarët e Kosovës, e cila u mbajt nga dy gazetarë të pavarur me shumë përvojë në raportimin e gjykimeve, veçanërisht të gjykimeve në TPNJ, GJPN dhe DHSK. Përfaqësuesit e DHSK-së iu përgjigjen pyetjeve konkrete lidhur me DHSK-në.

Pyetje nga gazetarët

